

FJALA E DEPUTETIT GRETA BARDELI

E ENJTE 16 SHTATOR 2021

Nëse do ta përkufizoja me disa fjalë qeverinë e re, e cila ka vetëm një fytyrë, ato janë: korrupsion dramatik, krimi i organizuar i lidhur me regjimin e pushtetit, rrënim ekonomik, familje në udhëkryq, emigracion masiv, shqiptarë të prerë në besë.

Të nderuar qytetarë,

Ju e dini shumë mirë dhe po e vuani çdo ditë cinizmin, arrogancën, fyerjen, talljen, përbuzjen e korrupsionit në zyrat e qeverisë; ju e dini shumë mirë se si ju peshojnë ato në xhepat tuaj duke përqeshur ndershmërinë tuaj. Si përfaqësuese e interesit të vendit tim, Shkodrës, dua t'i them qeverisë njëfytyrëse se nuk është përfaqësuese e interesit të tyre, por e botës së errët që u ka vrarë shpresën se ky vend mund të bëhet. Shkodra e di mirë se nuk ka qeveri për ta, Shqiptarët e dinë mirë se nuk ka program qeverisës për ta, por veç një oborr interesash kriminal, që përpiqen natë e ditë të fundosin qytetarinë dhe të ngrenë në pedestal hajdutërinë. Nga skajet më të largëta e deri në qendër njerëz të thjeshtë, gra, burra, me zakone, virtyte, dinjitet njerëzor ju kanë thënë jo, ju kanë përbuzur, sepse ju njohin mirë kush jeni dhe çfarë përfaqësoni.

Me politikën tuaj thelluat pabarazinë sociale, varfërinë e qytetarëve, papunësinë. Shumë qytetarë me të ardhura minimale dhe me pensione sot nuk blejnë dot as ilaçet e tyre as ushqimet bazë, ndërsa dhurata e fundit është rritja e çmimeve të produkteve ushqimore. Ju dilni dhe u thoni qytetarëve "prisni se po bëjmë qeverinë e re". Qesharakë deri në dhimbje. Modeli i pushtetit që kap shtetin për fyti, rrënon demokracinë dhe funksionin e shtetit të së drejtës është boshti juaj. Modeli i promovimit të njerëzve të korruptuar dhe të lidhur me krimin në qeveri dhe parlament është fytyra juaj. Flisni për mirëqenie, por ju janë errur sytë nga mirëqenia e oborrit tuaj. Falë jush vendi sot ndodhet në nivelet më të frikshme të ndotjes morale që ka njohur ndonjëherë. Si do ta zgjidhim problemin e pronës, ju që me qeverisjen tuaj keni prodhuar veç histori dhune dhe shkelje të ligjit, madje dhe mbi investitorë seriozë të huaj? Apo do ta zgjidhni ashtu siç zgjidhët çështjen e ndarjes së stacioneve në plazhe, sikurse ishte rasti i Velipojës, ku futët në sherr dhe në vrasje familje në Shkodër? Jeni të dështuar fund e krye. Ju u keni grabitur shqiptarëve perspektivën për një qeverisje të mirë për ta, duke i detyruar të ikin dhe të braktisin shtëpitë tyre. Gjatë qeverisjes suaj qarku i Shkodrës është në shifrat alarmante të emigracionit të rinjve dhe familjeve të reja të pashpresa për punë, të pashpresa në drejtësi dhe në dinjitetin njerëzor. Shkodra dhe Shqipëria meritojnë më të mirën. Ne do të jemi në këtë betejë me ta, për ta, për t'u kthyer besimin, kurajën dhe shpresën, për një vend ku demokracia dhe ligji nuk janë fasadë virtuale dhe në funksion të oligarkisë kriminale, por në shërbim të qytetarëve tanë të drejtë dhe të ndershëm. Faleminderit!